28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilit mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për të zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi , pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1 , Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

## Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi

i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

### **Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-1763-1-3-6/C938

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshimi ato jo relevante]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                  | Nr. Nenit |                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha        | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                           |
|                                     | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.                                                                                                                                                                                                                                  |
| Siguria e ekzekutimit               | 9.1       | <i>[Shëno shumën e sigurisë së ekzekutimit dhe pjesën në lidhje me shërbimet pas shitjes]</i>                                                                                                                                                                        |
| Sigurimi                            | 10.1      | <i>[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]</i>                                                                                                                                                                                                                 |
| Programi i ekzekutimit              | 11        | <i>Fillimi 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës nga palët në kontratë, përfundimi më së largu 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës</i>                                                                                                                                  |
| Tatimet dhe marrëveshjet doganore   | 12.1      | <i>Furnizuesi është i obliguar që të paguaj të gjitha taksat dhe tatimet që rrjedhin nga kjo kontratë, dmth konsiderohet se të gjitha taksat dhe tatimet janë llogaritur në çmimin e kontratës</i>                                                                   |
| Cilësia e furnizimeve               | 18.2      | <i>Cilësia e materialeve të furnizura duhet të jetë sipas specifikimeve të nenit 1 i kësaj kontrate</i>                                                                                                                                                              |
| Inspektimi dhe testimi              | 19.2      | <i>[Specifikoni vendin ku do të inspektohen mallrat]</i>                                                                                                                                                                                                             |
| Mbikqyrja e Kontrates               | 19.3      | <i>Menaxheri i Projektit caktohet Bestar Ibrahim ndërsa mbikqyrës i MDMK caktohet Elmaze Behluli</i>                                                                                                                                                                 |
| Pagesa                              | 20.1      | <i>Pagesa do të realizohet pas furnizimit të pajisjeve të kontraktuara dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës për çka do të hartojë raport me shkrim</i>                                                                                                           |
| Dorëzimi                            | 21.3      | <i>Furnizuesi është përgjegjës për transportin instalimin dhe vuarjen në funksion të pajisjeve</i>                                                                                                                                                                   |
| Obligimet e garancionit             | 24.1      | <i>Garancinë për pajisjet e furnizuara do të jetë sipas prodhuesit minimum 12 muaj apo sipas prodhuesit, nëse ka defekte në pajisjet e furnizuara furnizuesi është i obliguar t'i rregullojë apo nëse është nevoja edhe t'i zëvendësojë pa të drejtë kompensimi.</i> |
|                                     | 24.5      | <i>Furnizuesi do të dorëzojë sigurimin mbi kualitetin e pajisjeve në vlerë prej 1000.00€ në kohëzgjatje prej 12 muaj në momentin e dorëzimit të faturës.</i>                                                                                                         |
| Shërbimet pas shitjes               | 25.1      | <i>[Do defekt q/ paraqitet gjatë kohës së garancionit kontraktuesi është i obliguar që ta rregullojë me mjete të veta pa të drejtë kërkesë për kompensim]</i>                                                                                                        |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 31.2      | <i>Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë</i>                                                                                                                                                                                                     |

|                                                   |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 32.1 | <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë, ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</p> |
|---------------------------------------------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

### Furnizimi me panel Led të jashtëm dhe Smart Board

| N R. | PËRSHKRIMI I POZICIONIT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Njësia | Sasia | Çmimi per njësi me TVSH | Totali me TVSH |
|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------------------------|----------------|
| 1    | <b>Punet Pergaditore</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |        |       |                         |                |
| 1    | <p>Furnizimi dhe montimi me panel të jashtëm Led me karakteristika: Madhësia e pixelit 5mm, Dendësia e pixelit 40000 [Dots/m<sup>2</sup>, Led Lampa SMD 2525, Dimensioni 320x160x18.5, Rezulucioni 64x32=2048 Dots, Metoda e Drejtimit 8, Shkelqimi &gt;7000 cd/m<sup>2</sup>, Dukshmeri e mire &gt; 5m, Frekuenca e perseritjes &gt;3840 Hz, Ngjyra e imazhit 4398 Milyar, Paneli duhet të funksionoj me sistem ËIFI, Bluetooth të pranoj USB dhe të jete i lidhur me zyre të informimit me program kompjuterik nga i cili të menaxhohet. Paneli do të furnizohet dhe montohet në fasaden egzistuese gjysme strukturale të objektit të Komunes, për montim duhet të llogariten aksesoret e nevojshëm si profile metalike, bulona, furnizimi me kablllo elektrike etj. deri në funksionalizim të panelit, dimensionet e panelit të jete: Gjersia 3.20 m Lartësia 2.20 m</p> | cope   | 1.00  | 1940.00                 | 1940.00        |

|                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |      |      |         |           |
|----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------|---------|-----------|
| 2              | <p>SMART BOARD</p> <p>Specifikimet Teknike:</p> <p>Starboard TE-YL5 - SmartBoard<br/>Interactive Flat Panel Display 75",<br/>3840x2160, 4K, Touch Screen, 450 cd/m2,<br/>5000:1, &lt;8ms,<br/>Processor: ARM Cortex-A55, Quad Core,<br/>1.9GHz,<br/>Graphics: ARM Mali-G52<br/>Memory ram: 4GB, Memory Flash Drive:<br/>32GB EMMC,<br/>Android 11, Up to 20 Touch Points, 2 pens,<br/>HDMI: 2+1 Ports, RJ45 Network, USB-C:x1,<br/>DP: x1, Mic: x1, USB-A 3.0: 1+3 ports,<br/>Wi-Fi, Bluetooth, Video Outputs:<br/>VGA+YPBPR</p> | cope | 1.00 | 6000.00 | 6000.00   |
| TOTALI ME TVSH |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |      |      |         | 7940.00 € |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 02.05.2024

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

#### V E N D I M

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale** me numër identifikues: **613-24-1763-1-3-6**.

1. Bestar Ibrahim, Drejtoria për Administratë, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
  - a) Elmaze Behluli, Drejtoria për Administratë.
3. Menaxheri i kontratës, obligohet që të hartoj një Plan të Menaxhimit të Kontratës, duke përdorur formularin Standard të miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy palëve (Menaxherit të kontratës së AK dhe Menaxherit të Kontratës së OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë për menaxhim të kontratës janë:
  - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
  - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesit - vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kopje: Menaxherit të projektit;  
Mbikëqyrësve të kontratës;  
Departamentit të Prokurimit;

Zyrtari Kryesor Administrativ  
Imri Ahmeti



KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

## NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ FURNIZIM

☐ SHËRBEME

☐ PUNË

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Data e përgatitjes së njoftimit: 04.03.2024

|                 |                   |
|-----------------|-------------------|
| Nr i Prokurimit | 613-24-1763-1-3-6 |
| Nr i brendshëm  |                   |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

#### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

|                                       |                    |                         |
|---------------------------------------|--------------------|-------------------------|
| Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN  |                    |                         |
| Adresa Postare: SHQIPERIA             |                    |                         |
| Qyteti: LIPJAN                        | Kodi postar: 14000 | Vendi: Kosovë           |
| Personi kontaktues: Bekim Shabani     |                    | Telefoni: 038 200 41539 |
| Email: bekim.g.shabani@rks-gov.net    |                    | Faksi:                  |
| Adresa e Internetit (nëse aplikohet): |                    |                         |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

*Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi:*

|  |
|--|
|  |
|--|

### NENI II: LËNDA E KONTRATËS

**II.1) PËRSHKRIMI**

| <b>II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:</b><br>Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale                                                                                                                             |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|--------------|-------------------|-----------------------|--|--|--|
| <b>II.1.2) Lloji i kontratës dhe vendi i dorëzimit apo realizimit</b><br>(Zgjidhni vetëm një kategori - furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)                                                          |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <input checked="" type="checkbox"/> Furnizime                                                                                                                                                                                                                      | <input type="checkbox"/> Shërbime | <input type="checkbox"/> Punë                                            |              |                   |                       |  |  |  |
| <input checked="" type="checkbox"/> Blerja<br><input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing)<br><input type="checkbox"/> Qira<br><input type="checkbox"/> Blerje me këste<br><input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre                                     |                                   | <input type="checkbox"/> Riparim<br><input type="checkbox"/> Mirëmbajtje |              |                   |                       |  |  |  |
| Vendi apo vendndodhja kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit<br>Objekti i Komunës së Lipjanit                                                                                                                                                                   |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.3) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës</b><br>Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale                                                                                                                                          |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.4) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):</b><br>31211100-9                                                                                                                                                                           |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.5) Variantet pranohen</b><br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>                                                                                                                                                            |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.6) Ndarja në Pjesë</b><br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/><br><br>Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)<br><input type="checkbox"/> vetëm një pjesë <input type="checkbox"/> Të gjitha pjesët |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.7) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)</b> <table border="1"><thead><tr><th>Nr. i pjesës</th><th>Emërtimi i grupit</th><th>Përshkrimi i shkurtër</th></tr></thead><tbody><tr><td> </td><td> </td><td> </td></tr></tbody></table>                |                                   |                                                                          | Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |  |  |  |
| Nr. i pjesës                                                                                                                                                                                                                                                       | Emërtimi i grupit                 | Përshkrimi i shkurtër                                                    |              |                   |                       |  |  |  |
|                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |
| <b>II.1.8) Vlera e parashikuar e kontratës: 9,500.00</b>                                                                                                                                                                                                           |                                   |                                                                          |              |                   |                       |  |  |  |

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)  
Referoju paramases

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë 20 (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.2) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</b><br><br>a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i><br><br>a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosijen e tenderit. b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomikei lëshuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit (kopje). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës. |
| <b>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</b><br><br>Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i><br><br>Deshmi 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |

|                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
